



Projekti është financuar
nga Bashkimi Evropian



„МЛАДИНСКО УЧЕСТВО ЗА СИЛЕН И
ОДРЖЛИВ РАЗВОЈ НА ЗАЕДНИЦАТА“

DORACAK DEDIKUAR NËPUNËSVE PËR TË RINJTË

**DORACAK
DEDIKUAR
NËPUNËSVE
PËR TË RINJTË**

Prilep, 2023

TITULLI I PUBLIKIMIT

Doracak dedikuar nëpunësve për të rinjtë

НАСЛОВ НА ОРИГИНАЛОТ:

Прирачник за службеници за млади

PROJEKT

Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fortë dhe të qëndrueshëm të komunitetit

BOTUES

Koalicioni i organizatave rinore SEGA

PËR BOTUESIN

Zoran Ilieski, drejtor ekzekutiv i Koalicionit të organizatave rinore SEGA

AUTORË

Katica Janeva, konsulente e pavarur

Sanja Bozhoviq Stojkoska, konsulente e pavarur

REDAKTORË

Tomislav Gajtanoski,

Udhëheqës për Zhvillim të resurseve në Koalicionin e organizatave rinore SEGA

Jasmina Todorovska Miteva,

Oficere nacionale programore në Misionin e OSBE-së në Shkup

PËRKTHIMI DHE LEKTURA NGA GJUHA MAQEDONASE NË GJUHËN SHQIPE

"Santo Stef – S" DOOEL Shkup

TIRAZHI

100 kopje

DIZAJNI DHE SHTYPI

Brigada dizajn

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
35.077/.08-053.6(497.7)(035)

JANEVA, Katica

Doracak dedikuar nëpunësve për të rinjtë / [Katica Janeva, Sanja Bozhoviq Stojkoska]. – Shkup : Koalicioni i organizatave rinore SEGA, 2023. – 40 str. : илустр. ; 24 см

Превод на делото: Прирачник за службеници за млади. – Фусноти кон текстот. – Fjalorth: стр. 6-7. – Библиографија: стр. 33-35. – Содржи и: Aneksë. – Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fortë dhe të qëndrueshëm të komunitetit

ISBN 978-608-4631-18-7

1. Bozhoviq Stojkoska, Sanja [автор]

а) Службеници за млади -- Младински политики -- Јавна управа -- Македонија -- Прирачници

COBISS.MK-ID 60792069

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Misionit të OSBE-së në Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe Misionit të OSBE-së në Shkup.

Shprehjet e përdorura në gjininë gramatikore mashkullore në këtë doracak janë neutrale dhe u referohen si personave mashkullor ashtu edhe atyre femëror.

PËRMBAJTJA

HYRJE DHE QËLLIMI I DORACAKUT	5
FJALORTH	6
KAPITULLI 1	8
NËPUNËSIT PËR TË RINJTË.....	8
PSE NËPUNËS PËR TË RINJTË?.....	8
AKTIVITETET PËR AVANCIMIN E PJESËMARRJES SË TË RINJVE DHE POLITIKAVE RINORE.....	10
PROMOVIM I POZITËS NËPUNËS PËR TË RINJTË.....	12
BASHKËPUNIMI ME KËSHILLIN RINOR LOKAL DHE ORGANIN KËSHILLIMOR NACIONAL.....	14
VETËVLERËSIMI I PUNËS SUAJ.....	16
PËRFITIMET PËR NËPUNËSIT PËR TË RINJTË.....	19
SFIDAT PËR PERFORMANCËN ADEKUATE TË FUNKSIONIT.....	20
KAPITULLI 2	22
LEGJISLACIONI QË LIDHET ME TË RINJTË.....	22
ÇFARË PËRFSHIN LIGJI PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE DHE POLITIKAT RINORE?.....	22
STRATEGJIA NACIONALE PËR TË RINJ.....	23
LEGJISLACIONI I ÇËSHTJEVE PËR TË RINJTË.....	24
KAPITULLI 3	26
PROCESI I KRIJIMIT TË POLITIKAVE NË SEKTORIN PUBLIK.....	26
PROCESI I KRIJIMIT TË POLITIKAVE NË NIVEL LOKAL.....	26
PRAKTIKAT E MIRA TË BASHKËPUNIMIT MIDIS TË RINJVE DHE VETËQEVERISJES LOKALE.....	28
PROCESI I KRIJIMIT TË POLITIKAVE NË NIVEL NACIONAL.....	29
PRAKTIKA TË MIRA BASHKËPUNIMI MIDIS TË RINJVE DHE ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE.....	32
RESURSET SHITESË	33
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	34
ANEKSE	36

LISTA E SHKURTESAVE

ARS	Agjencia për Rini dhe Sport
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
NjQL	Njësitë e vetëqeverisjes lokale
FRE	Forumi Rinor Evropian
ShQ	Shoqatë Qytetare
LShF	Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet
LPRPR	Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore
KRL	Këshilli Rinor Lokal
KLR	Kuvendi Lokal i të Rinjve
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OBZhe	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
KB	Kombet e Bashkuara
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
SIGMA	Iniciativa e përbashkët e OBZhe-së dhe Bashkimit Evropian për dhënien e mbështetjes për përmirësimin e udhëheqjes dhe menaxhimit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

HYRJE DHE QËLLIMI I DORACAKUT

Ky doracak është i dedikuar për nëpunësit për të rinjtë në suaza të organeve të administratës shtetërore dhe njërive të vetëqeverisjes lokale dhe paraqet burim në punën me dhe për të rinjtë, organizatat rinore qytetare dhe aktorë të tjerë në fushën e politikave rinore. Doracak është përpiluar në bashkëpunim me Agjencinë për Rini dhe Sport, në kuadër të projektit "Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fortë dhe të qëndrueshëm të komunitetit", i mbështetur nga Bashkimi Evropian, dhe i implementuar nga Koalicioni i organizatave rinore SEGA në partneritet me SOS Fshati i Fëmijëve Maqedonia e Veriut, Qendra Vullnetare – Shkup dhe Shoqata "Forumi i Gruas" – Tetovë. Qëllimi i projektit është të përmirësojë cilësinë e zbatimit të politikës rinore bazuar në bashkëpunimin strukturor dhe pjesëmarrjen thelbësore të shoqërisë civile të rrjetëzuar. Përgatitja e doracakut dedikuar nëpunësve për të rinjtë u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Shkup.

Nëpunësit për të rinjtë janë persona të emëruar në institucionet që duhet të promovojnë politikat rinore dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Kjo pozitë është prezantuar për herë të parë me Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore.

Doracak përmban instruksione, udhëzime, shpjegime praktike dhe rekomandime për zbatimin e aktiviteteve të nëpunësve për të rinjtë në nivel nacional dhe lokal. Qëllimi i doracakut është të shpjegojë nocionet bazë që përmban Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore si dhe proceset për krijimin e politikave rinore, të propozojë aktivitete të mundshme për nëpunësit për të rinjtë, të jep udhëzime për bashkëpunim funksional dhe efektiv me sektorët tjerë, këshillat rinore lokale dhe organin këshillimor nacional. Një pjesë e veçantë e doracakut i kushtohet përgatitjeve të raporteve të punës, propozim formularëve të planit të punës si dhe formave për vetëvlerësim.

Të rinjtë janë bartës të ndryshimeve kreative dhe inovative në çdo shoqëri. Në atë drejtim, përmes mekanizmave dhe mjeteve të caktuara të rinjtë duhet t'i përcjellin idetë e tyre tek nëpunësi për të rinjtë. Ekzistimi i nëpunësit për të rinjtë ofron mundësi për zbatim më të lehtë të këtyre ideve dhe ndryshimeve në suaza të çdo politike brenda institucionit. Bashkëpunimi i suksesshëm me të rinjtë dhe format e të rinjve për shoqërim shpie drejt zbatimit të suksesshëm të politikave në nivel institucional dhe sektorial. Nga ana tjetër, rritja e njohurive për politikën rinore do të kontribuojë në zhvillimin e procedurave dhe rregullave brenda institucionit që do të sigurojnë zbatimin e qëndrueshëm të përfshirjes së të rinjve dhe politikave rinore.

Ky doracak duhet të shërbejë si mjet për nëpunësit për të rinjtë për t'i ndihmuar ata të zbatojnë dhe monitorojnë çështjet me interes për të rinjtë brenda kompetencave të administratës shtetërore, si dhe të vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore.

FJALORTH

Nëpunës për të rinjtë – person përgjegjës për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e çështjeve me interes për të rinjtë brenda fushëveprimit të kompetencave të institucionit. Organet e administratës shtetërore, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit janë të obliguara që të caktojnë nëpunës për të rinjtë. Nëpunësit për të rinjtë brenda komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, menaxhojnë edhe me zyrën për të rinjtë.

Të rinjtë – persona të rinj të moshës prej 15 deri në 29 vjeç.

Politikat rinore – është një grup masash dhe aktiviteteve që ndërmerren për përmbushjen e nevojave të të rinjve, me qëllim që të realizohet potenciali i tyre i plotë. Politika rinore është strategji e vendosur nga organet kompetente për t'u ofruar të rinjve mundësi për përfshirjen e tyre në zbatimin e politikave publike në nivel lokal dhe shtetëror.

Pjesëmarrja e të rinjve – proces përmes të cilit u mundësohet të rinjve të marrin pjesë dhe bashkrisht të marrin vendime për politikat dhe programet që formësojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi jetën e të rinjve. Pjesëmarrja e të rinjve u jep hapësirë të rinjve në mënyrë aktive të përfshihen në krijimin dhe vendimmarrjen për politikat dhe programet që janë të rëndësishme për ta.

Punarinore – paraqitet përmes një procesi të organizuar dhe sistematik edukimi dhe mbështetjeje të zhvillimit autentik të të rinjve për realizimin e potencialit të tyre të përgjithshëm personal, social dhe shoqëror dhe përfshirjen e tyre aktive në jetën e komunitetit.

Punëtorët me të rinjtë – persona të kualifikuar të aftë për të punuar me të rinjtë dhe për të zbatuar aktivitete që mbështesin zhvillimin personal dhe social të të rinjve përmes mësimi formal dhe jo formal.

Format e organizimit të të rinjve – prezantohen përmes shoqatave në organizata rinore, organizata për të rinjtë, organizata ombrellë të të rinjve.

Organizatë rinore – çdo organizatë e regjistruar në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet¹, në të cilën organi më i lartë vendimmarrës përbëhet nga së paku dy të tretat e të rinjve të moshës prej 15 deri në 29 vjeç dhe qëllimet dhe aktivitetet e së cilës janë të përcaktuara dhe të drejtuara në drejtim të avancimit të interesave të të rinjve.

Organizatë për të rinjtë – çdo organizatë e regjistruar në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet, e cila nuk udhëhiqet nga të rinjtë, pjesa e qëllimeve dhe aktiviteteve të programit janë të drejtuara drejt avancimit të interesave të të rinjve.

Organizatat ombrellë të të rinjve – janë organizata në të cilat anëtarësohen format e organizimit rinor të cilat janë të bashkuara për shkak të arritjes së qëllimeve të përbashkëta në fusha specifike me interes për të rinjtë.

¹ Ligji për Shoqata dhe Fondacione ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.52/2010, 135/2011 dhe 55/2016).

Asambleja Nacionale e të Rinjve – trup i formave të organizimit të rinisë që zgjedh përfaqësuesit e të rinjve në trupin këshillues, krijon prioritete dhe politika për përfaqësimin e përfaqësuesve të të rinjve dhe koordinon dhe monitoron punën e tyre.

Organi këshillimor nacional për politikat rinore – trup për bashkëpunim ndërmjet përfaqësuesve të të rinjve dhe përfaqësuesve të organeve të administratës shtetërore, i cili ka rol këshillues dhe mbikëqyrës në zbatimin e politikave rinore dhe aktiviteteve rinore.

Këshilli Rinor Lokal (KLR) – organ në kuadër të vetëqeverisjes lokale që përbëhet nga përfaqësues të rinj të formave të ndryshme të organizimit në komunë, i cili ka rol këshillues dhe përfaqësues për çështjet me interes të të rinjve në suaza të vetëqeverisjes lokale.

Kuvendi Lokal i të Rinjve – organ në kuadër të vetëqeverisjes lokale, i cili zgjedh anëtarët e Këshillit Rinor Lokal. Në Kuvendin për të rinj mund të anëtarësohen organizata rinore, organizata për të rinjtë, forumet rinore të partive politike, organizata të nxënësve dhe studentëve dhe format e tjera të organizimit të të rinjve.

Strategjia nacionale për të rinj – dokument strategjik që përcakton qëllimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave të të rinjve, si dhe përcakton masat organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tyre.

Strategjia lokale për të rinj – është dokument strategjik që në përputhje me Strategjinë nacionale për të rinj, përcakton qëllimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe avancimin e interesave të të rinjve në nivel lokal, si dhe përcakton masat organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tyre.

Zyra për të rinjtë – pikë primare e qasjes të të rinjve në nivel lokal, e themeluar nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, nga ku koordinohet puna për të rinjtë nëpër komuna.

Qendra rinore – vend ku përgatiten dhe zbatohen programe që përmirësojnë mirëqenien e të rinjve, zhvillimin e jetës personale, sociale dhe profesionale të të rinjve, informacione me interes të rëndësishëm për të rinjtë dhe aspekte të tjera të jetës së të rinjve.

Agjencia për Rini dhe Sport (ARS) organ shtetëror përgjegjës për të gjitha aspektet e jetës së të rinjve në vend. Një nga sektorët e punës së ARS-së është Sektori për rini, i cili ka një departament për politika rinore dhe një departament për eurointegrim dhe bashkëpunim ndërkombëtar të të rinjve. ARS-ja është përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e një numri të madh aktiviteteve nga sfera e të rinjve dhe politikave rinore, lidhur me kujdesin për statusin e të rinjve dhe zhvillimin e tyre psikofizik. Gjithashtu, ARS-ja është përgjegjëse për zhvillimin e Strategjisë nacionale për të rinj nëpërmjet një procesi konsultativ, gjithëpërfshirës dhe transparent, si dhe planeve aksionare për Strategjinë nacionale për të rinj. ARS-ja mban një regjistër të formave të organizimit të të rinjve i cili publikohet publikisht në internet faqen e agjencionit. Nëpunësit për të rinjtë kanë për detyrë të dorëzojnë raportet vjetore për punën deri te ARS-ja.

KAPITULLI 1

NËPUNËSIT PËR TË RINJTË

PSE NËPUNËS PËR TË RINJTË?

Përfshirja e të rinjve në punën e institucioneve ka një rëndësi thelbësore për zhvillimin e një shoqërie. Nëpërmjet prezantimit të kësaj qasjeje zhvillohet ndjenja e qytetarisë aktive dhe përkatësisë së të rinjve në shoqëri. Kur të rinjtë përfshihen që në fillim në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht për çështjet që shqetësojnë të rinjtë dhe janë pjesë e çdo zgjidhjeje të institucioneve, rritet edhe përgjegjësia ndaj politikave të miratuara. Sa më shumë të rinj të përfshihen në ndërtimin e një demokracie, aq më shumë kjo i mundëson “gjeneratës së ardhshme të vendimmarrësve” të avancojë dhe të ndërtojë demokracinë në shoqërinë e tyre.

Deri në miratimin e Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikave Rinore (LPRPR)², në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk parashikohej vende të veçanta pune brenda cilitdo institucion në lidhje me çështjet rinore³.

Për të treguar gatishmërinë dhe përkushtimin e institucioneve për përmirësimin e pozitës së të rinjve dhe dëgjimin e mendimeve dhe nevojave të tyre, ligjvënësi parashikoi që çdo organ i administratës shtetërore, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, duhet të caktojë “nëpunës për të rinjtë”.

Qëllimi i prezantimit të kësaj pozite është të mundësojë komunikim më të thjeshtë, më të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë mes të rinjve dhe institucionit të caktuar. Kjo pozitë është e njohur dhe e rëndësishme me atë që duhet të lidhë drejtpërdrejt të rinjtë dhe organizatat rinore me institucionin për sa u përket çështjeve dhe politikave rinore. **Nëpunësit për të rinjtë janë përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe avancimin e çështjeve, politikave dhe për pjesëmarrje të të rinjve brenda një institucioni. Ndër të tjera, nëpunësit për të rinjtë në nivel lokal, të emëruar në kuadër të komunave dhe Qytetit të Shkupit, janë përgjegjës edhe për funksionimin e zyrës për të rinjtë.** Të dhënat e nëpunësit për të rinjtë në çdo institucion duhet të jenë publike dhe të publikohen në faqen e internetit të institucionit, në mënyrë që çdo i ri i interesuar të mund ta marrë këtë informacion.

Të dhëna për të gjithë nëpunësit për të rinjtë janë në dispozicion dhe regullisht përditësohen në ueb faqen e ARS-së, në linkun e mëposhtëm:

<https://ams.gov.mk/mk/page/youth-officers>.

² Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikave Rinore (“Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr. 10/20).

³ Shembuj të tillë mund të gjenden në institucionet për fusha të tjera si personi i caktuar përgjegjës për zbatimin e Ligjit për qasje në informacione publike, personi i caktuar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, personi i caktuar përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve etj.

Nëpunësit për të rinjtë janë persona të punësuar në çdo institucion, në përputhje me Ligjin për nëpunësit administrativ⁴, të cilët në kryerjen e tyre të shërbimit publik do të kryejnë edhe funksionin “nëpunës për të rinjtë”. Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut⁵, nëpunësi për të rinjtë kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

1. zhvillimin, planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve në lidhje me të rinjtë dhe politikat rinore;
2. mbështetjen e punës së organit të administratës shtetërore, zbatimin e programit të tij, raportimin dhe transparencën;
3. ruajtjen e komunikimit dhe bashkëpunimit të rregullt me format e shoqatave rinore dhe me të rinjtë;
4. monitorimin e nevojave të të rinjve dhe realizimi i hulumtimeve për nevojat e organit të administratës shtetërore, komunës, konsultime me të rinjtë dhe monitorim dhe informim për analizat dhe hulumtimet për trendet tek të rinjtë;
5. sigurimin e informatave dhe informimin e të rinjve;
6. Mbajtjen e bazës së të dhënave për aktivitete të ndryshme rinore, forma aktive të shoqatave rinore dhe grupe joformale rinore për nevojat e Qendrës hulumtuese të Agjencisë për Rini dhe Sport;
7. Komunikim të rregullt me Agjencinë për Rini dhe Sport;
8. Të jetë kontakt për të gjitha çështjet rinore të organit të administratës shtetërore ndaj të rinjve dhe publikut.

Duke e pasur parasysh se kjo pozitë është e re, ajo duhet të zhvillohet dhe avancohet sipas përvojës dhe vëllimit të angazhimit që këto nëpunës ua kushtojnë të rinjve nga puna e tyre e përditshme. Ligji ka parashikuar shumë definicione dhe kompetenca mjaft të gjera për këtë pozitë, gjë që u lë hapësirë nëpunësve të emëruar të punojnë për avancimin e tij/Saj. Kështu, nëpunësit për të rinjtë mund të përkushtohen dhe të ndërtojnë karrierën e tyre përmes zhvillimit të një pozite unike që duhet të avancojë pozitën e të rinjve dhe të përmirësojë pjesëmarrjen e të rinjve dhe punën rinore.

⁴ Ligji për nëpunës administrativ (“Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr.27/14).

⁵ Proçesverbal nga seanca e pesëdhjetë e shtatë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 23 mars 2021.

AKTIVITETET PËR AVANCIMIN E PJESËMARRJES SË TË RINJVE DHE POLITIKAVE RINORE

Përfshirja e nëpunësit për të rinjtë në suaza të përgatitjes dhe zbatimit të politikave në nivel institucioni është e nevojshme, duke qenë se çdo politikë duhet të përfshijë të rinjtë. Nëpunësit për të rinjtë kanë mundësi të punojnë në zhvillimin e kësaj pozite nga disa aspekte, e si rrjedhojë të shfrytëzojnë potencialin maksimal të ekzistencës së një ideje të tillë pioniere.

Prandaj, më poshtë janë dhënë aktivitetet që çdo nëpunës për të rinjtë në nivel lokal dhe nacional mund t'i zbatojë në punën e vet. Si për çdo pozitë, edhe për nëpunësit për të rinjtë, kjo nuk është një listë përfundimtare, por mund të plotësohet dhe ndryshohet sipas nevojave të çdo institucioni.

Aktivitetet për avancimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe politikave rinore brenda çdo institucioni:

- zhvillimi i mundësive potenciale (aktivitete këshilluese, konsultative, koordinuese) për përfshirjen e të rinjve në procesin e politikëbërjes;
- zhvillimi i mekanizmave për përfshirjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes për aktivitete të rregullta sipas programit vjetor;
- përgatitja e bazës së veçantë të të dhënave të shoqatave dhe formave të shoqatave rinore, varësisht nga sektori i punës dhe në bashkëpunim me Agjencinë për Rini dhe Sport;
- pjesëmarrja në përgatitjen e dokumenteve të brendshme brenda institucionit (programi vullnetar, strategjia e komunikimit) me qëllim përfaqësimin e aspekteve rinore në çdo politikë publike;
- përcaktimi i prioriteteve gjysmëvjetore dhe vjetore për politikën rinore në institucion;
- përgatitja e një raporti vjetor për punën e institucionit në fushën e rinisë, çështjeve dhe politikave rinore dhe pjesëmarrjes së të rinjve;
- përcaktimi i nevojës për burime financiare nga institucioni për realizimin e prioriteteve për rininë dhe politikave rinore (pjesëmarrja në përgatitjen e buxhetit vjetor institucional);
- përgatitja e opinioneve për dokumente ligjore ose strategjike që mbulojnë ose duhet të mbulojnë çështjet dhe politikën rinore;
- përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për forcimin e aktiviteteve rinore dhe konsultimi me sektorët kyç brenda institucionit dhe zhvillimi i një kornize për rezultate;
- planifikimi dhe monitorimi i aktiviteteve për të rinjtë brenda institucionit;

- mbajtja e rregullt e takimeve informative dhe takimeve të punës me shoqatat rinore dhe qytetare;
- iniciimi dhe mbështetja e të rinjve dhe politikave rinore me interes për institucionin;
- bashkëpunim i rregullt me shkollat e mesme, institucionet e arsimit të lartë, qendrat e punësimit, qendrat për punë sociale dhe institucione të tjera;
- sigurimi i informatave dhe ndarja e tyre me të rinjtë përmes qasjeve të ndryshme për komunikim me të rinjtë (media sociale);
- komunikimi i rregullt me Agjencinë për Rini dhe Sport për shkëmbim të ndërsjellë të informacionit dhe konsultimeve për çështjet dhe politikat rinore;
- përgatitja e propozim aktiviteteve dhe temave për monitorim dhe hulumtim⁶;
- pjesëmarrja në përgatitjen e dokumenteve strategjike që i referohen drejtpërdrejt ose tërthorazi çështjeve dhe politikave rinore.

⁶ Këto aktivitete mund të jenë anketa, intervista, vlerësimi i aktiviteteve dhe proceseve të realizuara etj.

PROMOVIM I POZITËS NËPUNËS PËR TË RINJTË

Si çdo pozitë e re në çdo institucion, është e nevojshme të prezantohet, pra aktivitete për promovimin e punës së pozitës. Më poshtë janë paraqitur disa nga aktivitetet që mund të kryhen nga nëpunësit për të rinjtë.

Organizimi i takimeve informative me punonjës të tjerë në institucion

Organizimi i takimit informativ me punonjësit e tjerë nga institucioni do të ishte një shembull i mirë për informim adekuat të kolegëve. Në këtë takim është e nevojshme të prezantohen angazhimet themelore të realizuesit të detyrave të punës të parashikuara për këtë pozitë, të paraqitet nevoja për këtë pozitë për secilin institucion, prezantimi i mundësive për bashkëpunim dhe përfshirja e të rinjve në politikëbërje dhe vendimmarrje, të prezantohet detyrimi për përgatitjen e aktiviteteve dhe ndarja e informatave për të rinjtë, si dhe procesin e buxhetimit, pra financimin e aktiviteteve për të rinjtë. Me këtë qasje do të sigurohet disponueshmëri deri te kolegët, si dhe mundësia për bashkëpunim të ardhshëm. Është me rëndësi të madhe që kjo qasje do të mundësojë informimin e punonjësve dhe zyrtarëve të tjerë të nivelit më të lartë për situatën me të rinjtë dhe çështjet e të rinjve.

Organizimi i takimeve koordinative me organizatat rinore

Nëpunësi për të rinjtë, si dhe institucioni, mund të krijojnë mekanizma ose aktivitete përmes të cilave do të njohë të rinjtë, organizatat rinore dhe nevojat e tyre. Në kuadër të institucionit rekomandohet të organizohen takime koordinative për afrimin e institucionit me të rinjtë, por edhe njohjen e të rinjve me hapësirat e institucionit. Në këtë takim mund të prezantohen aktivitetet e deritanishme për të rinjtë nga institucioni. Fokusi më i madh duhet të vendoset në pjesën e takimeve ku të rinjtë dhe organizatat rinore do të mund të shprehin sfidat, opinionet, qëndrimet dhe propozimet e tyre për angazhimin e nëpunësit për të rinjtë në të ardhmen. Përmes këtyre takimeve mund të përgatitet dhe plotësohet baza e të dhënave me organizatat rinore.

Në përgatitjen dhe zbatimin e këtyre takimeve, nëpunësit për të rinjtë duhet të kenë kujdes që në punën e tyre të përfshijnë të rinjtë dhe grupet e të rinjve nga kategoritë e rrezikuara (të rinjtë nga komunitetet e rrezikuara, të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë nga zonat rurale, etj.).

Nëpunësit për të rinjtë në nivel lokal duhet të kenë takime të tilla koordinative me këshillat rinore lokale. Në varësi të temës së koordinimit, ndonjëherë këto takime duhet të organizohen me një rreth më të gjerë të organizatave rinore.

Përgatitja e një plani me aktivitete

Nëpunësit për të rinjtë kanë për obligim që të përgatisin raporte vjetore për punën e tyre, d.m.th. puna e institucionit tuaj në raport me të rinjtë, e cila do të shpallet publikisht. Si rezultat i këtyre raporteve, supozohet se duhet të zhvillohen plane të përshtatshme të aktiviteteve për çdo institucion. Gjatë përgatitjes së planit, nëpunësi për të rinjtë do të konsultohet me bashkëpunëtorët e tij d.m.th. kolegët si dhe planet në sektorë të ndryshëm që mund të përfshijnë të rinjtë me qëllim që të vendoset koordinim institucional. Prandaj është e nevojshme që nëpunësi për të rinjtë të ketë një pasqyrë të detajuar të të gjitha aktiviteteve që do të donte të realizonte në periudhën e ardhshme. Duke përdorur një tabelë të veçantë ose mjete të tjera, nëpunësi për të rinjtë do të ketë një pasqyrë të mirë të punës së vet, por edhe mundësinë për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve.

Prezantimi i planit të aktiviteteve brenda institucionit dhe para të rinjve

Ky plan i aktiviteteve duhet të shqyrtohet dhe të konsultohet me të gjitha sektorët në institucion, sepse padyshim që do të përfshijë mbështetjen e atyre sektorëve për realizimin e aktiviteteve. Është veçanërisht e rëndësishme që ky plan të konsultohet me sektorët e financave, se si mund të garantohet financimi i aktiviteteve dhe pjesëmarrja e nëpunësit për të rinjtë në procesin e përgatitjes së buxhetit të institucionit. Gjithashtu, plani tashmë i përgatitur i aktiviteteve, duhet të konsultohet me të rinjtë, në mënyrë që të gjitha palët të marrin pjesë në përgatitjen e tij.

Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara

Pas planit të përgatitur duhet të fillohet me zbatimin e aktiviteteve ashtu siç është parashikuar në plan. Megjithatë, plani tashmë i përgatitur nuk përjashton mundësinë e përsosjes apo përpunimit të tij gjatë periudhës së parashikuar njëvjeçare. Në këtë kuptim, shpesh në shoqëri ndodh që rrethanat shoqërore të ndryshojnë ose të ketë tema që në një moment të caktuar janë prioritare. Nëpunësi për të rinjtë duhet të jetë gjithmonë i hapur ndaj këtyre mundësive dhe ta përshtatë planin e tij/saj me situatën e re.

Shkëmbimi i informatave dhe dokumenteve me të rinjtë

Nëse pritet që të rinjtë të marrin pjesë në proceset e institucionit që kanë të bëjnë me ta, atëherë ata duhet të informohen në kohë. Nën informim me kohë në këtë formë, nënkuptohet që të rinjtë duhet t'u sigurohet një periudhë e mjaftueshme (të paktën 10 ditë, gjegjësisht dy javë e të ngjashme në varësi të aktivitetit, gjegjësisht politikës) për shqyrtimin e dokumenteve, politikave, gjegjësisht për përgatitjen e pjesëmarrjes në takim. Nëpërmjet kësaj qasjeje, të rinjtë do të mund të fitojnë besimin në vetë institucionin dhe në synimet e nëpunësve për të rinjtë për përfshirjen e tyre të plotë në të gjitha proceset.

Monitorimi i zbatimit të aktiviteteve

Me qëllim që të mund të përmbushen qëllimet që janë parashikuar për pozitën e nëpunësit për të rinjtë, të cilat janë të specifikuar në LPRPR-në, është e nevojshme të monitorohet zbatimi i secilit aktivitet. Pra, është e nevojshme të shihet nëse aktiviteti e ka përmbushur qëllimin e vet për të cilin është zbatuar, apo do të nevojiten aktivitete dhe përpjekje shtesë për zbatimin e duhur dhe gjithëpërfshirës të tij. Sipas kësaj, nëse organizohet një takim ku të rinjtë duhet të marrin pjesë në përgatitjen e një dokumenti të caktuar strategjik të institucionit, dhe një numër i vogël organizatash vijnë në takim, supozohet se nëpunësi për të rinjtë duhet të organizojë më shumë takime në mënyrë që të marrë mendimin e një numri më të madh të të rinjve dhe organizatave rinore.

BASHKËPUNIMI ME KËSHILLIN RINOR LOKAL DHE ORGANIN KËSHILLIMOR NACIONAL

Për hir të përfaqësimit dhe zbatimit të suksesshëm të politikave rinore dhe pjesëmarrjes së të rinjve, është i nevojshëm koordinimi i duhur ndërmjet të gjithë bartësve dhe palëve të interesuara të kësaj çështjeje. Duke qenë se politikat rinore nuk janë politika njësektoriale, pra politika të përcaktuara vertikalisht, por përkundrazi, avancimi i pozitës së të rinjve është një çështje horizontale, është i nevojshëm bashkëpunimi mes të gjithëve. LPRPR-ja paraqet një bazë ligjore mbi të cilën duhet të avancohet pozita e të rinjve, ndaj rekomandohet që nëpunësit për të rinjtë të mundësojnë avancimin e të gjitha procedurave të parashikuara sipas fushëveprimit të politikave të secilit institucion.



Në kuadër të kompetencave të nëpunësve për të rinjtë është edhe zhvillimi i procedurave të ndryshme këshilluese dhe procedurave për bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara. Është e nevojshme që institucionet e administratës shtetërore në punën dhe politikat e tyre rinore të monitorojnë dhe konsultojnë punën e Organit këshillimor nacional. Sipas kompetencave, ky organ ka rol këshillues dhe mbikëqyrës në zbatimin e politikave dhe aktiviteteve rinore për të rinjtë pranë organeve të administratës shtetërore, prandaj monitorimi i procesverbaleve nga mbledhjet, raporteve të punës, njoftimeve për mbledhje apo aktivitete të tjera të këtij organi do të të jetë në dobi të nëpunësve për të rinjtë.

Duke qenë se një pjesë e politikës rinore është programuar dhe zbatuar në nivel nacional, dhe një pjesë është programuar dhe zbatuar në nivel lokal, është i nevojshëm bashkëpunimi i nëpunësve të emëruar për të rinjtë në nivel nacional, me organet dhe personat përgjegjës për të rinjtë dhe politikat rinore në nivel lokal. Komunikimi dhe bashkëpunimi i rregullt i nëpunësve për të rinjtë në nivel nacional dhe lokal, me këshillat rinore lokale do të mundësojë edhe njohjen e nevojave dhe sfidave lokale rinore dhe kalimi i tyre në legjislacionin nacional, gjegjësisht kornizën strategjike.

Komunikimi me të rinjtë dhe informimi i të rinjve nga ana e nëpunësve për të rinjtë mund të bëhet përmes mjeteve standarde sociale (Facebook, Instagram, Twitter, etj.), por i njëjti mund të përmirësohet përmes bashkëpunimit të nëpunësve për të rinjtë me këshillat rinore lokale. Përmes bashkëpunimit të këshillave rinore lokale mundën në mënyrë të suksesshme të implementohen mënyra inovative të shkëmbimit të informatave (si e-gazetë⁷) ose mbledhjes së mendimit të të rinjve (nëpërmjet anketave të shkurtra⁸). Në këto këshilla janë anëtarësuar organizata të ndryshme lokale, kështu që nëpunësit për të rinjtë përmes kësaj qasjeje mundësojnë shkëmbimin e informacionit me të gjithë të rinjtë, pra përfshirjen e mendimit të të gjithë të rinjve.

Duke pasur parasysh dinamikën e sektorit rinor, nëpunësit për të rinjtë duhet të mbështesin politikën rinore dhe format e organizimit rinor përmes pranisë dhe promovimit të aktiviteteve që vijnë nga ky sektor. Shumë shpesh kjo përfshin pjesëmarrjen në një ngjarje, promovimin e hulumtimeve dhe të ngjashme, por prania e nëpunësve për të rinjtë jo vetëm që nënkupton mbështetje për organizatat rinore, por mundëson ata të njoftohen me sfidat e të rinjve "nga dora e parë", të arrijnë të njoftohen me të rinjtë dhe organizatat rinore, të njihen nga të rinjtë për punën dhe përkushtimin e tyre dhe të promovojnë punën dhe angazhimet e tyre.

⁷ Gazeta elektronike informon të rinjtë dhe të gjithë palët e interesuara për aktivitetet e kaluara, por edhe për aktivitetet dhe planet e punës së institucionit në të ardhmen. Këto revista elektronike mund të ndahen me email, por ato janë në dispozicio edhe në faqen e internetit të institucionit. Për më tepër, ato mund të promovohen përmes mediave sociale për të arritur deri tek më shumë të rinj.

⁸ Zbatimi i këtyre anketave të shkurtra përfshin pyetësorë të shkurtër (5-7 pyetje) që do t'u mundësojnë të rinjve të shprehin mendimin e tyre. Ato mund të përgatiten në internet dhe të shpërndahen përmes mediave sociale, ose t'u dërgohen të rinjve të synuar përmes adresave të emailit.

Sipas LPRPR-së, është paraparë ndarje e mjeteve nga buxheti i shtetit dhe buxhetet lokale⁹ për realizimin e aktiviteteve rinore. Ky angazhim i ligjvënësit është veçanërisht i rëndësishëm për qëllimin e mbështetjes së politikave në këtë fushë. Pikërisht për këtë është i rëndësishëm bashkëpunimi i nëpunësve për të rinjtë në nivel nacional dhe lokal me këshillat rinore lokale. Në atë drejtim, të gjitha angazhimet e organizatave rinore duhet të investohen në mbulimin sa më të madh financiar të aktiviteteve, aksion të koordinuar për sfidat më të spikatura të të rinjve, si dhe vëmendje në drejtimin e burimeve financiare në aktivitete unike, gjegjësisht aktivitete që nuk përsëriten në disa vende nga ana e disa institucioneve.

Rrjetëzimi ndërmjet nëpunësve për të rinjtë është i nevojshëm për çdo politikë rinore. Politikat rinore dhe pjesëmarrja e të rinjve gjithmonë mbulojnë sektorë dhe fusha të shumta, kështu që për hir të një koordinimi më të lehtë, shkëmbimit të informacioneve, synimit të drejtpërdrejtë të kompetencës dhe përgjegjësisë për politikat rinore, është e nevojshme që nëpunësit për të rinjtë të bashkëpunojnë dhe të rrjetëzohen çdo ditë në punën e tyre.

VETËVLERËSIMI I PUNËS SUAJ

Në përputhje me zotimet e LPRPR-së, nëpunësit për të rinjtë duhet të përgatisin raporte vjetore për punën e tyre, të cilat do të publikohen publikisht në ueb faqen e secilit institucion. Për përgatitje të suksesshme dhe gjithëpërfshirëse të raportit vjetor, por edhe me qëllim të vlerësimit të punës dhe angazhimit të nëpunësve për të rinjtë, rekomandohet që nëpunësit për të rinjtë të vlerësojnë suksesin e punës së tyre përmes vlerësimit.

Ky doracak sugjeron një formular vlerësimi, i cili mund të ndiqet siç është dhënë, por edhe të avancohet sipas zhvillimit dhe nevojave të pozitës. I njëjti është përgatitur në përputhje me përshkrimin e punës që u votua në seancën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe me aktivitetet e propozuara shtesë që çojnë në efikasitet, efektivitet dhe sukses të pozitës së "nëpunësit për të rinjtë".

Procesi i vetëvlerësimit në këtë formë nis me tre qëllime themelore që ka kjo pozitë: Respektimin dhe përfaqësimin e vlerave themelore për politikat rinore, një mjedis të favorshëm për të rinjtë dhe bashkëpunim aktiv me të rinjtë. Secili prej këtyre qëllimeve/shtyllave zërthehet më tej në aktivitete të përshtatshme. Në këtë kuptim, lista nuk është e hollësishme dhe gjithmonë mund të shtohen aktivitete dhe synime të reja për të avancuar këtë pozitë (aneksi 3).

QËLLIMI 1. Respektimi dhe përfaqësimi i vlerave themelore për politikat rinore:

- inkurajoj pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të të gjithë të rinjve të interesuar në procesin e vendimmarrjes dhe në përgatitjen e politikave rinore;
- komunikoj rregullisht me nëpunësit për të rinjtë në nivel lokal dhe nacional;
- i përfshij të rinjtë dhe organizatat rinore që i përfaqësojnë të drejtat e grupeve të marginalizuara dhe të rrezikuara të të rinjve në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes;
- rregullisht dhe bashkarisht ndërmarrim aktivitete në bashkëpunim me të rinjtë dhe organizatat rinore.


⁹ Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore ("Gazeta Zyrtare e RMV-se", nr.10/20, neni 25, paragrafi 1 dhe 2).

QËLLIMI 2. Mjedisi favorizues për të rinjtë:

- institucioni im njeh pozitën e “nëpunësit për të rinjtë” si përgjegjëse për politikat rinore dhe pjesëmarrjen e të rinjve;
- organizoj takime koordinative dhe këshilluese ndërmjet të rinjve, organizatave rinore dhe përfaqësuesve të institucionit;
- unë avokoj për përfshirjen sa më të madhe të të rinjve në procesin e vendimmarrjes dhe krijimit të politikave për të rinjtë;
- ndjek dhe zbatoj dokumente evropiane dhe ndërkombëtare për përmirësimin e pozitës së të rinjve;
- marr pjesë në përgatitjen e dokumenteve ligjore dhe strategjike të institucionit me qëllim avancimin e pozitës së të rinjve;
- marr pjesë në këshillimin dhe dhënien e propozimeve të institucionit për të integruar opinionet dhe interesat e të rinjve;
- janë arritur suksese në përfshirjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes dhe politikëbërjes brenda institucionit;
- institucioni ka krijuar qasje të ndryshme për komunikimin me të rinjtë dhe mbledhjen e mendimeve të tyre.

QËLLIMI 3. Bashkëpunim aktiv me të rinjtë:

- i informoj në mënyrë aktive të rinjtë për aktivitetet dhe politikat rinore të institucionit (informimi aktiv nënkupton informim të iniciuar nga institucioni, jo me kërkesë të të rinjve);
- ndihmoj dhe mbështes proceset për marrjen e informatave të nevojshme nga institucioni, të kërkuar nga të rinjtë;
- jam i/e njoftuar me programet dhe aktivitetet e formave të shoqatave rinore;
- sukseset e të rinjve i ndaj rregullisht me komunitetin e gjerë dhe brenda institucionit.



Kjo qasje do t'i ndihmojë nëpunësit për të rinjtë që në mënyrë më të thjeshtë të përgatisin raportin vjetor. Formulimi cilësor, gjegjësisht zgjedhja e qasjes përshkruese gjatë vetëvlerësimit të aktiviteteve, do t'u mundësojë zyrtarëve të shprehin sfidat me të cilat janë përballur.

Gjithmonë gjatë përgatitjes së vlerësimit, gjegjësisht vetëvlerësimit, është e nevojshme edhe matja kuantitative e aktiviteteve, matja përmes numrave, e cila do të ilustrojë shtrirjen e punës së nëpunësit për të rinjtë përmes numrave. Kjo është arsyeja pse ofrohet një listë e indikatorëve që do të ndihmojnë në përmbushjen e këtij qëllimi.

Indikatorët kuantitativ për matjen e punës së nëpunësve për të rinjtë:

- numri i masave të iniciuara për të rinjtë;
- numri i të rinjve dhe format e shoqatave rinore të përfshira në procesin konsultativ/këshillues;
- numri i takimeve të zhvilluara me të rinjtë dhe format e shoqatave rinore;
- numri i takimeve të zhvilluara me nëpunësit për të rinjtë nga institucione të tjera;
- numri i takimeve të zhvilluara me këshillat rinore lokale;
- numri i temave dhe pyetjeve të iniciuara hulumtuese;
- numri i konsultimeve të kryera me punonjësit e institucionit;
- numri i opinioneve/vërejtjeve të përgatitura ose formave të tjera të komunikimit formal dhe joformal me punonjësit e institucionit lidhur me rininë dhe çështjet rinore;
- numri i takimeve dhe ngjarjeve publike të organizuara nga format e shoqatave rinore, ku merr pjesë edhe nëpunësi për të rinjtë;
- numri i njoftimeve të iniciuara (komunikimi aktiv) me të rinjtë përmes mediave sociale;
- numri i mënyrave të reja inovative të komunikimit me të rinjtë;
- përgatitja e dokumenteve formale/joformale për komunikim të rregullt me të rinjtë;
- është përgatitur dhe përditësuar rregullisht baza e të dhënave e formave të shoqatave rinore për nevojat e institucionit;
- numri i aktiviteteve të kryera për shkak të pjesëmarrjes të nëpunësit për të rinjtë në krijimin e dokumenteve të tjera strategjike në institucion (strategjia e komunikimit, programi i vullnetarizmit, etj.);
- numri i aktiviteteve të realizuara dhe të kërkuara për financim nga buxheti shtetëror/lokal.

Kjo listë nuk është një listë e hollësishme dhe gjithmonë mund të shtohen indikatorë kuantitativ që do të shprehin me numra punën e nëpunësve për të rinjtë dhe institucionit.

PËRFITIMET PËR NËPUNËSIT PËR TË RINJTË

Vendosja e një pozite të tillë funksionale brenda çdo institucioni në nivel lokal dhe nacional thekson hapjen dhe mbështetjen e institucioneve për përfshirjen dhe zbatimin e çështjeve dhe politikave rinore në nivelin më të lartë. Njëkohësisht krijon edhe detyrime për institucionin për përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse, informimin e të rinjve, por edhe përfshirjen në çështjet dhe programet rinore si pjesë e punës së rregullt ditore të çdo institucioni. Kështu, nëpunësi për të rinjtë ka pozitë unike për të qenë urë, lidhje dhe mbështetje për përfshirje aktive të "gjeneratës së ardhshme të vendimmarrësve" brenda çdo institucioni.

Menaxhimi më efikas me nevojat dhe sfidat: përmes bashkëpunimit me institucionet, të rinjtë dhe format e shoqatave rinore, nëpunësit për të rinjtë do të mund të shprehin lirshëm nevojat dhe sfidat me të cilat përballen gjatë zbatimit dhe promovimit të politikave në nivel institucional. Kjo lloj qasje do të bëjë të mundur që të punohet së bashku me të rinjtë për tejkalimin e këtyre nevojave dhe sfidave, dhe në këtë mënyrë për të përmirësuar pozitën e nëpunësve për të rinjtë në nivel institucional.

Mundësia e të mësuarit në shumë nivele: bashkëpunimi me të rinjtë përfshin gjithmonë procesin e të mësuarit dhe përcjelljen e njohurive. Prandaj, ekziston një mundësi e vetme për nëpunësit për të rinjtë që ti plotësojnë njohuritë e tyre për politikën e reja rinore, sfidat rinore dhe të shkëmbejnë përvoja. Mundësia për të mësuar nga dora e parë nga ata që luftojnë për të drejtat dhe detyrat e tyre është padyshim një mundësi e shkëlqyer. Gjithashtu, duke pasur parasysh drejtimin që ka vendi (anëtarësimi në Bashkimin Evropian), nëpunësit për të rinjtë së bashku me të rinjtë do të kenë mundësinë të njihen me politikën rinore në nivel rajonal dhe evropian.

Avancimi në karrierë: përveç krijimit më të përgjegjshëm, transparent dhe të mbështetur financiarisht të politikave rinore dhe përfshirjes së të rinjve, nëpunësit për të rinjtë përmes përdorimit të qasjes aktive tek të rinjtë dhe formave të shoqatave rinore mund të ndihmojnë në forcimin e karrierës së tyre, d.m.th. në avancimin në vendin e tyre të punës. Duke u vendosur si drejtues të përgjegjshëm, pra politikëbërës, në një kohë kur shoqëria po përballlet edhe me sfida të tjera, nëpunësit për të rinjtë mund të punojnë për avancimin e pozitës së tyre në institucionin ku punojnë.



SFIDAT PËR PERFORMANCËN ADEKUATE TË FUNKSIONIT

Gjatë kryerjes së çdo funksioni të ri, ka disa sfida me të cilat mund të përballen nëpunësit për të rinjtë. Ky proces është i njohur edhe për pozitave të tjera të emëruara të cilat me angazhimin dhe përkushtimin e duhur kanë zënë vendin e tyre në çdo institucion.

1. Informimi i pamjaftueshëm për nëpunësin për të rinjtë në institucion

Ky funksion është i ri, ndaj ka gjithmonë mundësi që i njëjti të mos njihet siç duhet nga kolegët, përkatësisht punonjësit e tjerë në institucion. Nga ana tjetër, që nëpunësi për të rinjtë të ketë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për të gjitha politikave në institucion, është e nevojshme të njihet nga punonjësit e tjerë. Prandaj, organizimi i një takimi me punonjësit është i nevojshëm për njohjen dhe informimin e tyre. Me ndarjen e aktiviteteve nga plani i aktiviteteve, ndikohet edhe më shumë drejt pozicionimit të suksesshëm në institucion dhe pjesëmarrjes dhe kontributit në të gjitha aktivitetet.

2. Vullneti politik dhe institucional dhe mbështetja e zvogëluar për realizimin e pozitës

Për shkak të ndryshimit të pozitave, përkatësisht informimit të pamjaftueshëm për rëndësinë që ka kjo pozitë, mund të zvogëlohet mbështetja institucionale dhe politike e cila tashmë është vendosur. Pjesë e aktiviteteve të propozuara për tejkalimin e kësaj sfide sigurisht që duhet të jetë një takim me zyrtarin e institucionit, ku nëpunësi për të rinjtë do të prezantonte punën e deritanishme, si dhe aktivitetet e ardhshme. Si hap i radhës, mund të organizohet një takim konsultativ me të rinjtë, ku do të merr pjesë nëpunësi për të rinjtë dhe nivelet tjera drejtuese në institucion, ku ata mund të shprehin qëndrimet dhe propozimet e tyre për përmirësimin e punës së institucionit përmes zbatimit të duhur dhe gjithëpërfshirës të politikave rinore. Të rinjtë janë një kategori që padyshim mund të kontribuojnë në inovacion dhe kreativitet gjatë kryerjes së aktiviteteve të rregullta, ndaj rekomandohet kjo qasje.

3. Politikave rinore dhe pjesëmarrja e të rinjve nuk njihen si të nevojshme në punën e institucionit

Kjo sfidë mund të jetë veçanërisht e theksuar në institucionet që konsiderojnë se është e vështirë përfshirja e të rinjve në punën dhe politikave të tyre, pra institucionet që punojnë me të dhëna konfidenciale. Për këtë arsye, nëpunësi për të rinjtë duhet të qaset në mënyrë të duhur përmes ideve të veta, së bashku me organizatat rinore, ku përfshirja e institucioneve do të mund të ishte pa ndërprerje të punës dhe rregullave sipas të cilave funksionojnë institucione të caktuara. Të rinjtë duhet të mësojnë këto rregulla dhe rregullore në mënyrë që ata të mund të ushtrorjnë siç duhet të drejtat e tyre.

4. Mungesa e mbështetjes financiare për aktivitetet e institucionit

Mungesa e burimeve financiare është një sfidë serioze për nëpunësin për të rinjtë. Kështu kufizohen mundësitë për realizimin e aktiviteteve dhe përmirësimin e pozitës së të rinjve. LPRPR-ja parashikon financim të detyrueshëm për financimin e aktiviteteve të ligjit, përkatësisht 0.3% të buxhetit nacional, përkatësisht 0.1% të buxheteve të vetëqeverisjes lokale. Kjo duhet të jetë baza mbi të cilën nëpunësi për të rinjtë do t'u drejtohet hartuesve të buxhetit. Është e nevojshme që nëpunësi të jetë i përgatitur paraprakisht për nevojat e financimit të aktiviteteve (d.m.th., para fillimit të procedurës për krijimin e buxhetit – shih seksionin me hapat) në mënyrë që të jetë në gjendje t'i qaset këtij procesi në kohën e duhur. Më tej, në këtë drejtim, nëpunësi për të rinjtë duhet të shfrytëzojë rrjetëzimin ndërmjet nëpunësve për të rinjtë në nivel nacional dhe lokal, në mënyrë që të ketë koordinim dhe shfrytëzim maksimal të burimeve financiare. Gjithashtu, përmes procesit të rrjetëzimit, mund të shkëmbehen qasje pozitive ndërmjet nëpunësve për të rinjtë në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe efikasiteti i punës së tyre.

5. Ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm për organizatat rinore në institucionin me të cilin nëpunësi për të rinjtë mund të komunikojë

Shumë shpesh mund të ndodhë që nëpunësi për të rinjtë ta ketë të vështirë të identifikojë se me cilat organizata rinore mund të bashkëpunojë. Ndonjëherë kjo është vërtet një sfidë, por gjithashtu hap shumë mundësi për nëpunësin. Organizimi i më shumë takimeve konsultative mund të kontribuojë në përmirësimin e kësaj situatë. Kështu, do të jetë e mundur të njoh se cilat organizata janë aktive ose më pak aktive në këtë sektor dhe mund të përfshihen në punë. Për hir të përfshirjes së duhur të të gjithë të rinjve, ato organizata që janë më të vogla në numër, më pak aktive ose që punojnë me grupe të veçanta të rinjsh duhet të inkurajohen të marrin pjesë dhe të përfshihen në takime. Edhe takimet e gjera me organizata të shumta në baza të rregullta do të kontribuojnë shumë më tepër në idetë inovatore dhe qasje kreative brenda institucionit. Gjithashtu, informimi dhe dërgimi në kohë i dokumenteve dhe informacioneve për të rinjtë do të kontribuojë në njohjen e duhur të tyre me punën dhe veprimtarinë e institucionit dhe për njohjen e vendit të vet në krijimin e politikave të institucionit.

KAPITULLI 2

LEGJISLACIONI QË LIDHET ME TË RINJTË

ÇFARË PËRFSHIN LIGJI PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE DHE POLITIKAT RINORE?

Në vitin 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore. Në fakt, kjo është zgjidhja e parë ligjore në vend që rregullon përfshirjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes nga institucionet në nivel nacional dhe shtetëror.

Ligji duhet të forcojë pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe detyron institucionet të sigurojnë edhe informimin aktiv, promovimin dhe mbrojtjen e interesave të të rinjve, si dhe forcimin e ndërgjegjësimit shoqëror për rolin e të rinjve në shoqëri.

Ky ligj njih **pavarësinë, pluralizmin dhe demokracinë në të gjitha format e organizimit të të rinjve në të gjitha nivelet** dhe njih disa forma të organizimit të të rinjve dhe përfshirjen e tyre në politikëbërje në nivele të shumfishta.

Me këtë ligj, të rinjtë dhe organizatat rinore fituan regjistrin e tyre, të ashtuquajturin *Regjistrin e organizatave rinore dhe organizatave për të rinj*¹⁰, i cili menaxhohet nga Agjencia për Rini dhe Sport.

Angazhimi i shtetit dhe i institucioneve për avancimin e pozitës rinore dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse, shprehet përmes krijimit të *Organit këshillimor nacional për politikën rinore*, si Organ këshillimor nacional.

Në nivel lokal gjithashtu ekzistojnë edhe forma të organizimit të të rinjve, kështu që *këshillat rinore lokale* janë paraparë si organe në kuadër të komunave dhe Qytetit të Shkupit. Deri në miratimin e këtij ligji, shumë komuna i kishin paraparë këshillat rinore lokale si një organizatë rinore me rol këshillues dhe përfaqësues në komuna, por me miratimin e këtij ligji edhe këshillat rinore lokale morën zgjidhjen e tyre ligjore.

Si pika kontakti për të rinjtë me autoritetet në të gjitha nivelet, janë parashikuar disa forma, përkatësisht zyra për të rinjtë, qendra rinore dhe nëpunësit për të rinjtë.

¹⁰ Agjencia për Rini dhe Sport, Regjistri i organizatave qytetare, në dispozicion në: <https://ams.gov.mk/mk/page/register-of-youth-organizations>, qasja është bërë më 14 gusht, viti 2022.

STRATEGJIA NACIONALE PËR TË RINJ

Strategjia nacionale për të rinj¹¹ është një dokument që synon të përmirësojë pozitën e përgjithshme të të rinjve në vend, duke promovuar pjesëmarrjen dhe mirëqenien e tyre. Strategjia e parë për të rinj në Republikën e Maqedonisë së Veriut u miratua në vitin 2005 nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kohëzgjatja e tij ishte parashikuar për një periudhë 10 vjeçare, pra nga viti 2005 deri në vitin 2015.

Gjatë vitit 2015 filluan konsultimet për përgatitjen e një strategjie të re për të rinj. Ky proces i përpilimit të strategjisë u drejtua nga Agjencia për Rini dhe Sport në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Pas procesit të zhvilluar konsultativ, në vitin 2016 u miratua një Strategji e re nacionale për të rinj¹². Kjo strategji u miratua sërish për një periudhë dhjetëvjeçare, pra për periudhën 2016–2025. Kjo strategji është e ndarë në 9 fusha, të cilat duhet të kontribuojnë në përmirësimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, përkatësisht: pjesëmarrja e të rinjve, puna rinore lokale, informimi i të rinjve, punësimi, arsimit, kultura, sporti, shëndeti dhe cilësia e jetës.

Kohëzgjatja e Strategjisë nacionale për të rinj 2016–2025 është shkurtuar me LPRPR-në dhe me parashikimin e një strategjie të re për një periudhë kohore pesëvjeçare. Për zbatimin e kësaj Strategjie nacionale është duke u përpiluar një Plan aksionar për realizim me aktivitete të përcaktuara, dinamikën, bartësit e aktiviteteve dhe projeksioneve të mjeteve buxhetore, si dhe kushtet dhe indikatorët për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë nacionale për të rinj. Kohëzgjatja e një Plani aksionar mund të jetë nga një deri në tre vjet, gjegjësisht për zbatimin e një Strategjie nacionale për të rinj do të jetë e nevojshme të miratohen të paktën dy plane aksionare. Planet aksionare, si dhe Strategjia nacionale për të rinj, miratohen nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për aktivitetet e parashikuara në këto plane aksionare, pra për zbatimin e qëllimeve të Strategjisë nacionale për të rinj sigurohen mjete nga buxheti shtetëror. Planet aksionare përgatiten nga Agjencia për Rini dhe Sport, por për miratimin e tyre, gjegjësisht dorëzimin në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është e nevojshme që Agjencia të marrë mendim nga Organi Nacional Këshillëdhënës për të rinj.

¹¹ Strategjia nacionale për të rinj 2016–2025 dhe Plani aksionar për realizimin e saj, në dispozicion në: <https://ams.gov.mk/mk/page/youth-strategies>, qasja është bërë më 14 gusht 2022.

¹² Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Strategjia nacionale për të rinj 2016–2025 e miratuar, marrë nga: <https://vlada.mk/node/11816>, qasja është bërë më 25 gusht 2022.

LEGJISLACIONI I ÇËSHTJEVE PËR TË RINJTË

Pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendimmarrëse, në kuadër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk garantohet vetëm në nivel shtetëror dhe lokal përmes ekzistencës së LPRPR-së. *Ligji për arsimin e lartë*¹³ ka pjesën e vet të gjerë që ka për qëllim shoqatat studentore, kuvendin studentore dhe pjesëmarrjen e tyre demokratike në procesin e vendimmarrjes në nivel fakulteti, universiteti dhe ndëruniversitar. Ky ligj parashikon pjesëmarrjen e studentëve në procesin e vendimmarrjes në nivel fakulteti dhe universiteti përmes një procesi demokratik dhe përfaqësimit të interesave të të gjithë studentëve.

Ndryshe nga Ligji për arsimin e lartë, *Ligji për arsimin e mesëm*¹⁴ nuk përfshin dispozita për organizimin e shkollës së mesme dhe pjesëmarrjen në politikëbërje dhe vendimmarrje në nivelin e shkollës së mesme, edhe pse ekziston nevoja për përfshirjen e tyre, veçanërisht duke pasur parasysh se ekzistojnë tashmë forma të organizimit të shkollave të mesme dhe komunikojnë me institucionet e të gjitha niveleve. Krijimi i qytetarëve aktiv, të vetëdijshëm për sfidat dhe përgjegjësitë në shoqëri, është i domosdoshëm që në fazën më të hershme. Prandaj organizimi i shkollave të mesme është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të përgjithshëm në vend, për të mësuar dhe praktikuar demokracinë.




¹³ Ligji për arsimin e lartë, teksti i konsoliduar, ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 82/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 178/2021).

¹⁴ Ligji për arsimin e mesëm, teksti i konsoliduar, („Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017, 64/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 229/2020).

Në vitin 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi *Ligjin për shtesën rinore*¹⁵, qëllimi parësor i të cilit është përmirësimi i jetës së të rinjve në vend. Ky ligj parashikon nxitjen e punësimit të të rinjve në veprimtari prodhuese pas përfundimit të arsimit të mesëm. Në këtë mënyrë, njëkohësisht kontribuon në përmirësimin e standardit të tyre të jetesës dhe në të njëjtën kohë në plotësimin e nevojave të punëdhënësve me fuqi punëtore të kualifikuar. Shuma e kompensimit financiar – shtesa për të rinjtë e paraparë me këtë ligj është 3.000 denarë në muaj dhe është paraparë t'u paguhet të rinjve deri në 23 vjet me së paku arsim të mesëm. Sipas këtij Ligji, shtesa për të rinjtë synohet të përdoret nga një i ri që:

- mbulohet nga sigurimi social i detyrueshëm në bazë të punësimit të një punëdhënës ose vetëpunësimit me veprimtari kryesisht prodhuese;
- është i punësuar në një agjenci private punësimi dhe është caktuar të punojë te një punëdhënës me një aktivitet kryesisht prodhues, ose përfshihet në sigurimin social të detyrueshëm si fermer individual.

Politikat rinore përfshijnë shumë aspekte të të drejtave dhe funksionimit të të rinjve në një shoqëri. Gjatë ndërtimit të të rinjve si qytetarë aktiv, është e nevojshme të theksohet dhe të njihet përfshirja e tyre në vullnetarizëm. Vullnetarizmi i të rinjve dhe termi vullnetar në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i rregulluar me *Ligjin për Vullnetarizëm*¹⁶. Ky ligj në vetvete rregullon të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve, si dhe të organizatorëve të vullnetarizmit, promovon vullnetarizmin në shoqëri dhe ndalon rreptësisht abuzimin e tij. Për të mundësuar regjistrimin e vullnetarizmit, ligji parashikon një librezë vullnetari ku shënohet perioda e vullnetarizmit, organizatori i vullnetarizmit, lloji i punës vullnetare dhe trajnimet që ka marrë vullnetari gjatë procesit të vullnetarizmit.



¹⁵ Ligji për shtesë rinore ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.18/2020).

¹⁶ Ligji për vullnetarizëm ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.85/2007).

KAPITULLI 3

PROCESI I KRIJIMIT TË POLITIKAVE NË SEKTORIN PUBLIK

PROCESI I KRIJIMIT TË POLITIKAVE NË NIVEL LOKAL

Krijimi dhe miratimi i politikave dhe programeve vendore është përgjegjësi e organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale (NJVL), ndërsa administrata komunale ka një rol të madh në zbatimin e tyre. Me programe dhe plane rregullohen dhe përpunohen çështje të caktuara për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera që i janë bartur në kompetencë të komunës dhe për të cilat është e nevojshme të parashikohen afatet dhe dinamika e zbatimit të tyre.

Procesi i decentralizimit u mundësoi qytetarëve të marrin pjesë në krijimin e programeve lokale të aktiviteteve, përmes zbatimit të formave të ndryshme të demokracisë direkte dhe pjesëmarrëse si iniciativat qytetare, petitionet, referendumet, forumet, tubimet qytetare etj. Në lidhje me krijimin e politikave, planeve dhe programeve specifike, pushteti lokal mund të konsultohet drejtpërdrejt me grupin e prekur të qytetarëve.

Komunat duhet të ofrojnë një listë të shërbimeve që janë në përgjegjësinë e tyre si: planifikimi urban, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës, zhvillimi ekonomik lokal, veprimtaritë komunale, kultura, sporti dhe rekreacioni, mbrojtja sociale, arsimit, kujdesi shëndetësor, mbrojtja dhe shpëtimi i qytetarëve, mbrojtje nga zjarri. Këto shërbime prekin drejtpërdrejt të rinjtë dhe ndikojnë në mirëqenien e tyre në komunitet. Prandaj, të rinjtë duhet të konsultohen për çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet komunale.

Nëpunësi për të rinjtë duhet të përfaqësojë lidhjen ndërmjet të rinjve dhe sektorëve të ndryshëm komunal në drejtim të zbatimit të shërbimeve të ndryshme komunale.

Për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve, rekomandohet përdorimi më i shpeshtë i pyetësorëve dhe anketave elektronike, aplikacioneve në internet. Komunat gjithnjë e më shumë po përdorin faqet e tyre të internetit dhe mediat sociale për të informuar, njoftuar, por edhe për të reaguar ndaj komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të marra.

Komunat mund të arrijnë bashkëpunim ndërkomunal përmes themelimit të organeve dhe komisioneve të përbashkëta, organeve administrative, ndërmarrjeve publike, institucioneve publike ose një komunë mund të kryejë punë për komunat tjera. Bashkëpunimi ndërkomunal duhet të mbulojë edhe çështjet që janë me interes për të rinjtë dhe politikat rinore në një territor më të madh. Prandaj, është e nevojshme që nëpunësit për të rinjtë nga komuna të ndryshme të komunikojnë dhe shkëmbejnë rregullisht informata për avancimin e politikave rinore dhe përmirësimin e jetës së të rinjve në një rajon të caktuar.

Përpilimi i dokumenteve strategjike për politikat rinore dhe zbatimi i aktiviteteve të pjesëmarrjes së rinjve në nivel lokal përfshin disa implikime financiare brenda buxhetit komunal.

Buxheti i komunës përcaktohet me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale¹⁷ dhe vlen për një periudhë prej një viti fiskal dhe fillon më 1 janar dhe zgjat deri më 31 dhjetor. Baza për përgatitjen e buxheteve të komunave janë prioritetet strategjike të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, propozimi i planeve strategjike të përfituesve buxhetor dhe politikës buxhetore, si dhe prioritetet e komunave.

Procesi i buxhetimit në nivel lokal

Nëpunësi për të rinjtë duhet të jetë i njohur me procesin e miratimit të buxhetit në nivel lokal, veçanërisht me kalendarin buxhetor, i cili përcakton afatet për planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit për vitin e ardhshëm fiskal. Nëpunësi për të rinjtë duhet të marrë pjesë aktive në krijimin e buxhetit të komunës duke paraqitur një propozim për llogaritjet në periudhën qershor/korrik. Sektori për buxhete i komunës analizon kalkulimet e propozuara të dorëzuara dhe sipas tyre përcaktohen prioritetet. Ministria e Financave, me datën 30 shtator, i dorëzon kryetarit të komunës një qarkore buxhetore që përmban udhëzimet për përgatitjen e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale për vitin e ardhshëm buxhetor dhe informata për grantet për njësitë e vetëqeverisjes lokale, të cilat transferohen nga buxheti qendror. Pas pranimit të qarkores buxhetore, kryetari i komunës i paraqet Këshillit të komunës një propozim kalendar buxhetor që përmban të gjithë procedurën e miratimit të buxhetit me datat e mundshme për realizimin e atyre aktiviteteve. Pastaj kryetari dhe shërbimet komunale përgatisin një qarkore buxhetore komunale e cila u dërgohet shfrytëzuesve të buxhetit. Nëpunësit për të rinjtë duhet të përfshihen në këtë proces në të cilin punohet për propozim-planin dhe programet zhvillimore dhe mbahen dëgjime publike dhe i dorëzohen Këshillit për shqyrtim jo më vonë se 20 tetori i vitit aktual. Më së voni deri më 15 nëntor, Këshilli do të miratojë programet e propozuara. Në periudhën deri më 25 nëntor, buxheti prezantohet publikisht në mediat elektronike, zhvillohen debate publike dhe grumbullohen propozime nga qytetarët, shoqatat e qytetarëve dhe komuniteti i biznesit. Deri më 1 dhjetor, kryetari i komunës ia paraqet buxhetin Këshillit, i cili zhvillon një debat për të dhe e miraton në fund të dhjetorit.

Kryetari i komunës është përgjegjës për zbatimin dhe realizimin e buxhetit. Në fund të çdo viti fiskal miratohet buxheti vjetor i komunës, dokument ky i disponueshëm për publikun.

Përfshirja e nëpunësve për të rinjtë në procesin e krijimit të buxhetit në nivel lokal është jashtëzakonisht e rëndësishme për përfaqësim efektiv, gjegjësisht nga buxhetet e komunave që për të rinjtë të ndajnë fonde në shumën prej së paku 0.1% në vit të përcaktuar sipas Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore.

Nga ana e personave të caktuar në komunë rregullisht monitorohet zbatimi i strategjive të miratuara dhe programeve të punës në nivel lokal. Përveç monitorimit të strategjive lokale, bëhet vlerësimi i zbatimit të dokumenteve strategjike për të përcaktuar nëse synimet e planifikuara të politikës lokale janë arritur në mënyrë efikase sipas treguesve të përcaktuar. Kështu matet dhe vlerësohet zbatimi i politikave lokale rinore.

¹⁷ Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 61/2004, faqe 2).

PRAKTIKAT E MIRA TË BASHKËPUNIMIT MIDIS TË RINJVE DHE VETËQEVERISJES LOKALE

Në procesin e konsultimit të të rinjve, institucionet duhet të kenë parasysh diversitetin e tyre, siç janë përkatësia etnike, prejardhja socio-ekonomike, niveli i arsimit, si dhe interesat e tyre të përbashkëta.

Themelimi i këshillave rinore lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut filloi shumë më herët se miratimi i LPRPR-ja. Ekzistojnë më shumë iniciativa të veprimit të organizatave rinore të shoqërisë civile për të krijuar modelin e këshillave rinore nëpër komuna. Për shembull, Koalicioni i organizatave rinore SEGA ka punuar në krijimin e modelit të këshillave rinore nëpër komuna që nga viti 2008. Edhe Misioni i OSBE-së në Shkup në periudhën 2015–2020 ka realizuar aktivitete specifike për forcimin e këshillave rinore lokale në disa komuna, përmes një procesi të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të këshillave rinore lokale, mbështetje për funksionimin e tyre si dhe mbështetjen dhe përgatitjen e strategjive lokale për të rinj dhe zbatimin e planeve aksionare. Në fakt, me mbështetjen dhe ekzistencën e një mekanizmi të tillë konsultimi me të rinjtë në nivel lokal, shkaktoi një nevojë shtesë për rregullimin e kësaj fushe dhe miratimin e shembujve të tillë pozitiv nga të gjitha pushtetet lokale.

Për momentin, të rinjtë janë të përfshirë më së shumti në realizimin e projekteve të mbështetura nga organizata vendase apo ndërkombëtare. Si shembull mund të përmendim aktivitetet e realizuara në komunat Çair, Kumanovë, Aerodrom dhe Kisella Vodë në fushën e mjedisit jetësor. Është një nismë e të rinjve aktivistë të shoqatës “Go Green”, të cilët zbatojnë kërkesat ekologjike të të rinjve. Është pozitive që disa nga këto kërkesa tashmë janë përbushur¹⁸.

Një shembull tjetër pozitiv janë “Bankat lokale rinore” e drejtuar nga organizata “Të rinjtë munden” me synim identifikimin e nevojave të të rinjve në nivel lokal, të cilën të rinjtë e ndjekin. Bankat rinore përfaqësojnë një model dhe program inovativ për krijimin e granteve që zbatohet në komunat Karposh, Gjorçe Petrov dhe Aerodrom, përmes të cilave mundësohet financimi i aksioneve lokale për financimin e propozimeve për përmirësimin e pozitës së të rinjve në komunë¹⁹.

¹⁸ Go green, <https://www.bidizelen.org/>

¹⁹ Youth can, <https://youthcan.org.mk/>

PROCESI I KRIJIMIT TË POLITIKAVE NË NIVEL NACIONAL

Procesi i krijimit të politikave publike në nivel nacional përfshin krijimin e një kornize ligjore për një çështje specifike (ligje) ose krijimin e dokumenteve dhe planeve strategjike për disa çështje. Në këtë drejtim, është e nevojshme që nëpunësit për të rinjtë të jenë në gjendje të kuptojnë se cilat nga çështjet rinore kërkojnë rregullim me tekste të caktuara ligjore dhe cilat çështje duhet të jenë përcaktime strategjike të institucioneve.

Një nga parimet e OBZHE /SIGMA për krijimin e politikave publike efektive është zhvillimi i politikave dhe legjislationit që është gjithëpërfshirës dhe i bazuar në dëshmi²⁰. Ky është në fakt një nga parimet më të rëndësishme gjatë krijimit të një politike rinore. Në çdo institucion, inicimi i një politike apo mase specifike rinore duhet të jetë përgjegjësi e nëpunësve për të rinjtë. Në fakt, koordinimi dhe menaxhimi i të gjithë procesit duhet të drejtohet nga ata. Gjithëpërfshirja e të rinjve dhe përfshirja e tyre mund të sigurohet nëpërmjet proceseve konsultative, apo të kryhen hulumtime për opinionin e tyre, por ka edhe mjete që në mënyrë të strukturuar, sipas dispozitave, sigurojnë pjesëmarrjen e të rinjve të interesuar në procesin e krijimit të teksteve ligjore. Një vegël e tillë është *Regjistri Unik Nacional Elektronik i dispozitave të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, ose shkurt ENER²¹, ku çdo nen i një ligji të propozuar, pra amendamenti dhe plotësimi i propozuar, është i hapur për konsultim dhe komente. Propozimet mund të pranohen ose refuzohen nga institucioni dhe institucioni ka detyrimin t'i shpjegojë parashtruesit të propozimit. Mu kjo vegël mund të përdoret nga nëpunësit për të rinjtë për të shkëmbyer informata me të rinjtë dhe organizatat rinore, si dhe përfshirjen e tyre në krijimin e politikave me rëndësi për ta.

Gjatë krijimit të dokumenteve dhe planeve strategjike nuk ka asnjë procedurë strikte për t'u ndjekur (përsa i përket krijimit të teksteve ligjore), gjë që lë mundësinë e rregullimit të tyre sa herë që është e nevojshme. Prandaj, është e nevojshme që nëpunësit për të rinjtë t'i drejtohen kryesisht grupit të prekur, përkatësisht të rinjve dhe organizatave rinore. Sfidat dhe nevojat e të rinjve mund të nxirren më së miri nga grupi i prekur. Shumë shpesh, për probleme të caktuara, tashmë janë përgatitur hulumtimet, kështu që angazhimet dhe opinionet fillestare do të bazohen në dëshmi. Nisur nga nevoja, mund të mbahen më shumë takime dhe mbledhje me palët e interesuara, pasi ato përfaqësojnë bazën për krijimin e qëllimeve, aktiviteteve dhe indikatorëve për një politikë specifike brenda çdo institucioni.


Gjatë mbledhjes së informacionit dhe opinionëve, institucionet dhe nëpunësit për të rinjtë mund t'i qasen përdorimit të mënyrave të reja inovative të mbledhjes elektronike së të dhënave (anketime të shkurtra, opinione të drejtpërdrejta, grumbullim elektronik i opinioneve) nga të rinjtë me qëllim që të arrijnë deri te të gjithë të rinjtë. Në mënyrë që procesi të jetë gjithëpërfshirës duhet t'i kushtohet vëmendje përfshirjes së të rinjve nga zonat rurale, të rinjve nga bashkësitë e ndryshme etnike, të rinjve nga grupet e rrezikuara si dhe grupeve të tjera të të rinjve në mënyrë që të realizohet procesi gjithëpërfshirës.

²⁰ OBZHE/SIGMA (Mbështetje për të përmirësuar qeverisjen dhe menaxhimin), Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave Publike, në dispozicion në: <https://goo.gl/iIATLU> qasja është bërë më 25 gusht 2022.

²¹ I vetmi regjistrë elektronik nacional i rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://ener.gov.mk/Default.aspx>.

Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tilla për politikat publike, shpesh ndodh që të ketë një partneritet ndërmjet dy ose më shumë institucioneve, pra organizatave. Një partneritet i tillë mund të kontribuojë në krijimin e një dokumenti publik që është relevant dhe përfaqëson interesat e shumë palëve. Nëpunësi për të rinjtë mund të jetë fasilitator ose lehtësues i të gjithë procesit. Nëpunësi për të rinjtë mund ta koordinojë këtë proces nga jashtë (të rinjtë dhe format e shoqatave rinore) por edhe nga brenda (mes kolegëve në institucion). Gjatë bashkëpunimit me institucionet, përkatësisht me nëpunës tjerë për të rinjtë, është e nevojshme t'u kushtohet vëmendje të gjitha dokumenteve strategjike tashmë të miratuara dhe planeve për zbatimin e tyre në mënyrë që të shmangen aktivitetet gjatë së njëjtës periudhë.

Çdo politikë, dhe rrjedhimisht çdo politikë rinore, bart me vete implikime financiare. Implikimet financiare shprehen nëpërmjet fondeve të nevojshme për të mbështetur një aktivitet nga buxheti qendror/nacional. Procesi i "buxhetimit të aktiviteteve" duhet të zhvillohet kryesisht brenda institucionit, por edhe jashtë në bashkëpunim me të rinjtë dhe institucionet e tjera. Një qasje e tillë është e nevojshme në mënyrë që të mos mbivendoset mbështetja financiare e këtyre aktiviteteve me mbështetjen financiare të të njëjtave aktivitete nga palë të tjera të interesuara.



Procesi i buxhetimit në nivel nacional

Në drejtim të mbështetjes financiare të aktiviteteve, nëpunësi për të rinjtë duhet të njohë mirë procesin e miratimit të buxhetit. Buxheti i referohet periudhës së një viti fiskal, pra nga 1 janari deri më 31 dhjetor. Por krijimi i buxhetit nis shumë më herët edhe atë që në qershor/korrik, kur kërkohet angazhimi i nëpunësit për të rinjtë²². Sipas institucionit, gjatë kësaj periudhe përgatitet një Propozim Plan për programet zhvillimore, i cili i dorëzohet Ministrisë së Financave. Më tej, deri në datën 1 shtator, çdo institucion dorëzon një "Propozim kërkesë buxhetore" në Ministrinë e Financave. Pas shqyrtimit të të gjitha kërkesave buxhetore nga të gjitha institucionet, Ministria e Financave dorëzon propozim buxhetin në Qeveri, e cila deri më 15 nëntor duhet të dorëzojë propozim buxhetin në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për diskutim. Buxheti për vitin e ardhshëm duhet të miratohet deri më 31 dhjetor të vitit paraprak. Në këtë drejtim është i domosdoshëm angazhimi i nëpunësve për të rinjtë me qëllim që të ndahen 0.3% të mbështetjes financiare për zbatimin e LPRPR-së dhe për t'i shpërndarë ato sipas aktiviteteve. Për këtë arsye komunikimi dhe koordinimi i rregullt me të gjitha sektorët në institucion do të çonte në përfshirjen dhe njoftimin në kohë të nëpunësit për të rinjtë për fazën në të cilën ndodhet procesi i financimit.

Një politikë e caktuar publike, pra një dokument i caktuar duhet të miratohet gjithmonë nga niveli më i lartë, që të shpreheshin përcaktimet më të larta të institucionit për politikë rinore. Miratimi i politikave në nivelin më të lartë do të thotë që politikat duhet të miratohen nga funksionarët e organeve. Krahas kësaj, mund të ketë shumë masa për të rinjtë për të cilat do të jetë i nevojshëm koordinimi ndërmjet të gjitha organeve dhe për këtë arsye është e nevojshme të miratohen dokumente dhe plane strategjike në nivel të Qeverisë, gjegjësisht seanca të Qeverisë (Strategjia nacionale për të rinj). Meqenëse politika të ndryshme miratohen në nivele të ndryshme brenda institucionit, nëpunësit për të rinjtë janë kompetent për të synuar autoritetin, d.m.th. udhëheqësin/funksionarin që miraton politikën.

Pas miratimit të duhur të një strategjie apo plani specifik, fillon procesi i zbatimit, si dhe monitorimi dhe vlerësimi. Këto aktivitete janë veçanërisht të rëndësishme sepse matin suksesin e një politike të caktuar, pra paraqesin bazën për planifikimin dhe zbatimin e politikave të reja. Në këtë drejtim, është e nevojshme që çdo politikë publike të përmbajë indikatorë që do të masin suksesin dhe shkallën e ndikimit të saj ndaj dhe për politikat rinore.



²² Ligji për buxhet, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, tekst i redaktuar, në dispozicion në: <https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2022/02/Закон-за-бюжете-Пречистен-текст.pdf>

PRAKTIKA TË MIRA BASHKËPUNIMI MIDIS TË RINJVE DHE ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Miratimi i **Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore** është shembull i shkëlqyer i bashkëpunimit të organizatave rinore me institucionet qeveritare dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në fakt, miratimi i një teksti të tillë ligjor së bashku me të rinjtë përfaqëson nivelin më të lartë të pjesëmarrjes në krijimin e politikave të përbashkëta për të rinjtë. Procesi ishte gjerësisht gjithëpërfshirës dhe filloi në vitin 2018, duke përfshirë një grup punues trepalësh të formuar nga Klubi për Çështje dhe Politika Rinore në Kuvendin e RMV-së, i cili u mbështet nga NDI në të cilin morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të organizatave rinore dhe përfaqësues të të rinjve të partive politike. Konsultimet për miratimin e ligjit u zhvilluan në kuadër të grupit të punës, takime të veçanta pune me aktorë të tjerë shtesë, si dhe konsultime në nivel lokal. Ky proces u mbështet plotësisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup.

Grupi i punës MASH-RINI është një shembull pozitiv i një institucioni specifik si Ministria e Arsimit me përfaqësues të organizatave rinore, Asamblesë Studentore Universitare dhe Unionit të Gjymnazistëve. Ky grup ka autoritetin për të diskutuar, bashkëpunuar dhe gjetur zgjidhje për të gjitha problemet aktuale që prekin gjymnazistët dhe studentët, si dhe për krijimin e politikave, masave dhe aktiviteteve të reja rinore²³. Deri më tani ky grup ka bashkëpunuar për miratimin e disa iniciativave, si Ligji për nxënësit, pra Ligji për standardet e nxënësve dhe të ngjashme.

Garancia rinore, gjegjësisht garancia për të rinjtë, është gjithashtu një shembull pozitiv i pranimit të mendimeve dhe qëndrimeve të organizatave rinore, pra bashkëpunimi me to dhe me institucionet në nivel nacional. Ajo që duhet përmendur është se organizatat rinore civile, prej disa vitesh dhe në disa raporte dhe raste, avokojnë për përfshirjen e “garancisë për të rinjtë” si pjesë e programeve të qeverisë në luftën kundër papunësisë së të rinjve. Vetëm pas një periudhe të caktuar ky program bëhet pjesë e programit të qeverisë dhe fillon të zbatohet në vend.

*Garancia rinore ose garancia për të rinjtë*²⁴ është një program i promovuar nga KE në vitin 2013 dhe ka forcuar më tej zbatimin e tij në të gjitha vendet e BE-së në vitin 2020. Republika e Maqedonisë së Veriut është vendi i parë që nuk është anëtar i BE-së, i cili vendosi të anëtarësohet dhe e zbatoi këtë program në vitin 2018. Me Planin e Investimeve Ekonomike të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, Garancia rinore u parashikua si një nga nismat kryesore dhe për të mund të përdoret edhe mbështetja e IPA 3. Ky program përfshin të gjithë të rinjtë nën moshën 29 vjeç, të cilët nuk janë të regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit dhe kanë përfunduar tashmë shkollimin. Ky proces i futjes së garancisë për të rinj paraqet gjithashtu shembull pozitiv të pranimit të mendimeve dhe qëndrimeve të organizatave rinore, përkatësisht bashkëpunimi me to dhe institucionet në nivel nacional. Ajo që duhet përmendur është se organizatat qytetare rinore, prej disa vitesh dhe në disa raporte dhe raste, përipiqen për përfshirjen e “garancisë për të rinjtë” si pjesë e programeve qeveritare në luftën kundër papunësisë së të rinjve.

²³ Ministria e Arsimit dhe Shkencës, standardet e nxënësve dhe studentëve do të vazhdojnë të përmirësohen përmes Grupit të punës MASH – Rini, në dispozicion në: <https://mon.gov.mk/content/?id=5872>, qasja është bërë më 26 gusht 2022.

²⁴ Garancia për të rinj, Agjencia për Punësim, informacione në dispozicion në: <http://av.gov.mk/garancija-za-mladi.nsp.x>, qasja është bërë më 20 gusht 2022.

RESURSET SHITESË

Në këtë pjesë mund të gjeni burime shitesë për politikat rinore dhe pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje rajonale dhe ndërkombëtare. Njohja e politikave rinore në nivel ndërkombëtar do të kontribuojë në punën më të suksesshme dhe përfaqësimin e interesave rinore në secilin institucion. Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës, gjegjësisht aspiron të jetë anëtare e Bashkimit Evropian, njohja e angazhimeve aktuale dhe të ardhshme të këtyre organizatave për politikat rinore dhe pjesëmarrjen e të rinjve është jashtëzakonisht e rëndësishme për vendin tonë.

1. Strategjia për të rinjtë e Bashkimit Evropian 2019 – 2027, https://europa.eu/youth/strategy_en
2. Politika rinore e Këshillit të Evropës, <https://www.coe.int/en/web/youth/council-of-europe-youth-policy>
3. Mirë se vini në Fjalën e ke til! Doracak për Kartën e reviduar Evropiane për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale, Këshilli i Evropës, nëntor 2015, <https://rm.coe.int/have-your-say-manual-mk/168072a38a>
4. Strategjia për të rinj 2030 e Kombeve të Bashkuara, https://www.un.org/youthenvoy/wp-content/uploads/2018/09/18-00080_UN-Youth-Strategy_Web.pdf
5. Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, <https://sdgs.un.org/2030agenda>
6. Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nju Jork, 1989)

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.10, 16.01.2020).
2. Agjencia për Rini dhe Sport, Strategjia nacionale për të rinj 2016–2025 dhe Plani aksionar për zbatimin e saj, në dispozicion në: <https://ams.gov.mk/mk/page/youth-strategies>
3. Agjencia për Rini dhe Sport, Regjistri i Organizatave qytetare, në dispozicion në: <https://ams.gov.mk/mk/page/register-of-youth-organizations>
4. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Strategjia nacionale për të rinj 2016–2025 e miratuar, marrë nga: <https://vlada.mk/node/11816>
5. Doracak për këshillat rinore lokale, Agjencia për Rini dhe Sport dhe Misioni i OSBE-së në Shkup, 2021, në dispozicion në: <https://www.osce.org/mk/mission-to-skopje/491135>
6. Regjistri i vetëm nacional elektronik i rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://ener.gov.mk/Default.aspx>
7. OBZhE/SIGMA (Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit), Zhvillimi dhe koordinimi i politikave publike, në dispozicion në: <https://goo.gl/iIATLU>
8. Ligji për shtesë rinore, ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.18, 27.01.2020).
9. Garancia për të rinj, Agjencia për punësim, informata në dispozicion në: <http://av.gov.mk/garancija-za-mladi.nspX>
10. Ligji për arsimin e lartë, teksti i konsoliduar, ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 82/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 178/2021).
11. Ligji për arsimin e mesëm, teksti i konsoliduar, ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017, 64/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 229/2020).
12. Ligji për vullnetarizëm, ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 85/07, 09.07.2007).
13. Strategjia për promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit për periudhën 2021–2025 dhe Plani i zbatimit (plani aksionar), https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/trud/Volonterstvo_2021_2025.pdf

14. Strategjia nacionale për të rinj 2016–2025 dhe Plani aksionar për zbatimin e saj, në dispozicion në: <https://ams.gov.mk/mk/page/youth-strategies>
15. Regjistri i organizatave civile, në dispozicion në: <https://ams.gov.mk/mk/page/register-of-youth-organizations>
16. Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 61, 13.09.2004, faqe 2).
17. [Strategjia nacionale për të rinj](#) (2005–2015), Agjencia për Rini dhe Sport.
18. Karta evropiane për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale, [Microsoft Word – Charter for youth participation.doc \(salto-youth.net\)](#)
19. Strategjia për Sektorin e Rinisë 2030, Këshilli i Evropës, <https://rm.coe.int/background-document-youth-sector-strategy-2030-english/1680a0bb33>
20. Qëllimet evropiane për të rinjtë, [European Youth Goals | European Youth Portal \(europa.eu\)](#)
21. Rezoluta e Këshillit të Bashkimit Evropian, Strategjia e BE-së për Rininë, 2019–2027 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3A0J.C_2018.456.01.0001.01.ENG&toc=0J%3AC%3A2018%3A456%3AFULL
22. Partneriteti ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në fushën e rinisë <https://pjp-eu.coe.int/en/web/youth-partnership/youth-work2>
23. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, rezoluta 217 A (III), data 10.12.1948.
24. Rezoluta mbi Politikat Rinore, Forumi Rinor Evropian, 1998, [176–98–E \(youthforum.org\)](#)
25. Forumi Rinor Evropian, "Policy paper on youth rights", (2012) në dispozicion në: <https://tools.youthforum.org/policy-library/wp-content/uploads/2021/04/Policy-Paper-on-Youth-Rights.pdf>
26. Ligji për nëpunës administrativ ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.27/14).

Aneksi 2 – Raport mbi zbatimin e planit vjetor të punës së nëpunësit për të rinjtë

Nëpunësit për të rinjtë përgatisin raporte vjetore për punën e institucioneve në suaza të fushës së të rinjve, të cilat i dorëzojnë në Agjencinë për Rini dhe Sport dhe i publikojnë në ueb-faqet e institucionit të tyre.

Numri i dokumentit:

Vendi dhe data:

Kontakti:

Përgatitur nga nëpunësi për të rinjtë:

Raport për zbatimin e planit vjetor të punës të nëpunësit për të rinjtë në komunën XXXX për vitin XXXX

Shembuj:

Detyra 1: Zhvillimi, planifikimi dhe monitorimi i aktiviteteve në lidhje me të rinjtë dhe politikat rinore

Lista e aktiviteteve të realizuara:

Aktiviteti 1

- Emri/lloji i aktivitetit
- Përshkrimi i aktivitetit
- Data e zbatimit
- Qëllimi i aktivitetit
- Rezultati i arritur
- Të dhëna për numrin e takimeve, numrin e pjesëmarrësve (në proporcion ndërmjet djemve dhe vajzave), profilin e pjesëmarrësve, komunikimin etj.

Zbatuesit e aktivitetit:

Mjetet e shpenzuara për realizimin e aktivitetit:

Sfidat dhe mësimet e nxjerra në zbatimin e kësaj detyre:

Aktiviteti 2

- Emri/lloji i aktivitetit
- Përshkrimi i aktivitetit
- Data e zbatimit
- Qëllimi i aktivitetit
- Rezultati i arritur
- Të dhëna për numrin e takimeve, numrin e pjesëmarrësve (në proporcion ndërmjet djemve dhe vajzave), profilin e pjesëmarrësve, komunikimin, rrjetet sociale etj.

Zbatuesit e aktivitetit:

Mjetet e shpenzuara për realizimin e aktivitetit:

Sfidat dhe mësimet e nxjerra në zbatimin e kësaj detyre:

Detyra 2: mbështetja e punës së komunave, zbatim i programit të saj, raportimi dhe transparenca

Lista e aktiviteteve të realizuara:

Aktiviteti 1

- ↳ Emri/Iloji i aktivitetit
- ↳ Përshkrimi i aktivitetit
- ↳ Data e zbatimit
- ↳ Qëllimi i aktivitetit
- ↳ Rezultati i arritur
- ↳ Të dhëna për numrin e takimeve, numrin e pjesëmarrësve (në proporcion ndërmjet djemve dhe vajzave), profilin e pjesëmarrësve, komunikimin etj.

Zbatuesit e aktivitetit:

Mjetet e shpenzuara për realizimin e aktivitetit:

Sfidat dhe mësimet e nxjerra në zbatimin e kësaj detyre:

Aktiviteti 2

- ↳ Emri/Iloji i aktivitetit
- ↳ Përshkrimi i aktivitetit
- ↳ Data e zbatimit
- ↳ Qëllimi i aktivitetit
- ↳ Rezultati i arritur
- ↳ Të dhëna për numrin e takimeve, numrin e pjesëmarrësve (në proporcion ndërmjet djemve dhe vajzave), profilin e pjesëmarrësve, komunikimin, rrjetet sociale etj.

Zbatuesit e aktivitetit:

Mjetet e shpenzuara për realizimin e aktivitetit:

Sfidat dhe mësimet e nxjerra në zbatimin e kësaj detyre:

Detyra 3:

Aktivitetet që transferohen në vitin e ardhshëm:

Konkluzioni i përgjithshëm për zbatimin e planit vjetor të punës:

Anekset

Dokumentet shitesë si programet, agjendat, raportet nga takimet dhe aktivitetet, etj. mund të dorëzohen si bashkëngjitje.

Aneksi 3 – Tabela për vetëvlerësimin e punës së nëpunësve për të rinjtë

Numri	Aktiviteti	Po	Pjesërisht	Jo	Përshkrim i shkurtë / vërejtje
QËLLIMI 1: Respektimi dhe përfaqësimi i vlerave themelore për politikat rinore					
1.	Unë inkurajoj pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të të gjithë të rinjve të interesuar në procesin e vendimmarrjes dhe në përgatitjen e politikave rinore				
2.	Unë komunikoj rregullisht me nëpunësit për të rinjtë në nivel lokal dhe nacional				
3.	Unë përfshij të rinjtë dhe organizatat rinore që i përfaqësojnë të drejtat e grupeve të marginalizuara dhe të rrezikuara të të rinjve në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes				
4.	Rregullisht dhe bashkarisht ndërmarrim aktivitete në bashkëpunim me të rinjtë dhe organizatat rinore				
QËLLIMI 2: Një mjedis i favorshëm për të rinjtë					
5.	Institucioni im njih pozitën e "Nëpunësit për të rinjtë" si përgjegjës për politikat rinore dhe pjesëmarrjen e të rinjve				
6.	Organizoj takime koordinuese dhe këshilluese ndërmjet të rinjve, organizatave rinore dhe përfaqësuesve të institucionit				
7.	Unë avokoj për përfshirjen sa më të madhe të të rinjve në procesin e vendimmarrjes dhe krijimin e politikave për të rinjtë				
8.	Unë ndjek dhe zbatoj dokumente evropiane dhe ndërkombëtare për përmirësimin e pozitës së të rinjve				
9.	Marr pjesë në përgatitjen e dokumenteve ligjore dhe strategjike të institucionit me qëllim përmirësimin e pozitës së të rinjve				
10.	Marr pjesë në këshillimin dhe dhënien e sugjerimeve institucionit për të integruar opinionet dhe interesat e të rinjve				
11.	Janë arritur suksese në përfshirjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes dhe politikëbërjes brenda institucionit.				
12.	Institucioni ka krijuar qasje të ndryshme për komunikimin me të rinjtë dhe grumbullimin e mendimeve të tyre				

Numri	Aktiviteti	Po	Pjesërisht	Jo	Përshkrim i shkurtë / vërejtje
QËLLIMI 3: Bashkëpunimi aktiv me të rinjtë					
13.	I informoj në mënyrë aktive të rinjtë për aktivitetet dhe politikat rinore të institucionit (informimi aktiv nënkupton informim të iniciuar nga institucioni, jo me kërkesë të të rinjve)				
14.	Ndihmoj dhe mbështes proceset për marrjen e informatave të nevojshme nga institucioni, të kërkuar nga të rinjtë				
15.	Jam i/e njoftuar me programet dhe aktivitetet e formave të shoqatave rinore				
16.	Unë sukseset e të rinjve i ndaj rregullisht me komunitetin e gjerë dhe brenda institucionit				

